



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI
VENDIM
Nr. 219, Datë 04.07.2023

MBI

PEZULLIMIN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME APLIKIMIN E SHOQËRISË “EU GREEN ENERGY” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA PARKU EOLIK I ERËS “DROPULLI WIND”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 MW

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 14, pika 10, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.07.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1069/9 prot., datë 30.06.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku eolik i erës “Dropulli Wind”, me kapacitet të instaluar 20 MW”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 158, datë 05.05.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik “Dropulli Wind” me kapacite të instaluar 20 MW, në Njësinë Administrative Jorgucat, Bashkia Dropull, Qarku Gjirokastër.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 06.05.2023 dhe 08.05.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 04.06.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresën nr. 1069/7 prot., datë 15.05.2023, ERE i është drejtuar shoqërive “EU GREEN ENERGY” sh.p.k., “WINPHARMA” sh.p.k. dhe “A.91” sh.p.k., të cilat kanë krijuar bashkimin e përkoshëm për të cilin MIE ka dhënë dhe Autorizimin Paraprak me nr. 469/5, datë 07.12.2021, për ndërtimin e impiantit eolik 20 MW, në Dropull, Gjirokastër, në lidhje me zhvillimin e një seance dëgjimore me qëllim përcaktimin e shoqërisë që do të mbajë licencën për këtë impiant e po ashtu për të sqaruar pjesën tjetër të dokumentacionit të konstatuar të munguar.
- Në vijim të seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 05.06.2023 dhe pas sqarimeve të dhëna në këtë seancë shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1271/3 prot., datë 06.05.2023.

- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, me shkresën nr. 1271/7 prot., datë 20.06.2023, ERE i evidentoi shoqërisë dokumentacionin që mbetej ende pa u plotësuar në këtë aplikim.
- Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 05.06.2023 në ERE, nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë është deklaruar se i vetmi dokument që ka mbetur për të plotësuar dosjen përkatëse për të vijuar me VKM-në dhe vendimin final të MIE-s për këtë projekt është përfundimi i procedurave për të lidhur kontratën e qirasë për të gjithë sipërfaqen e që shtrihet projekti, gjë që kushtëzohet nga konstituimi i Këshillit të ri Bashkiak të Bashkisë Dropull, për këtë arsye për të plotësuar të gjithë dosjen e aplikimit në ERE mund të nevojitet dhe zgjatje e vendimmarrjes finale për licencim.
- Për sa më sipër dhe me qëllim për t'i dhënë mundësinë shoqërisë që të depozitojë në ERE dokumentacionin thelbësor të këtij aplikimi, i cili nuk varet vetëm nga përpjekjet e shoqërisë, vlerësohet të pezullohet vendimmarrja e bordit mbi aplikimin e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. për t'u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku eolik i erës “Dropulli Wind”, me kapacitet të instaluar 20 MW.
- Në nenin 14, pika 10, e *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike* e ndryshuar, parashikohet se bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij..

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pezullojë vendimmarrjen për aplikimin e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik “Dropulli Wind” me kapacite të instaluar 20 MW, në Njësinë Administrative Jorgucat, Bashkia Dropull, Qarku Gjirokastrë, deri s shoqëria të depozitojë në ERE dokumentacionin si më poshtë vijon:
 - aktin përkatës mbi dhënien e dakordësisë për shoqërinë kryesuese të Bashkimit të Përkohshëm (të shoqërive “EU GREEN ENERGY” shpk, “WINPHARMA” shpk dhe “A.91” shpk) e cila do të marrë dhe licencën nga ERE dhe do të operojë centralin) duhet t'i referohet parkut eolik 20 MW;
 - VKM-në përkatëse dhe kontratën e nënshkruar me MIE-n për ndërtimin e parkut eolik “Dropulli Wind”, me kapacitet 20 MW,;
 - përcaktimin e mënyrës së financimit të projektit dhe depozitimin e dokumentacionit të mbështetjes financiare referuar mënyrës së financimit;
 - saktësimin e numrit të njërive gjeneruese (agregatëve eolikë), në referencë të kapacitetit total të parkut eolik (20 MW);
 - miratimin përfundimtar të OST sh.a. për pikën e lidhjes me rrjetin.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI